



Prishtinë, 22 dhjetor 2010
Kodi i ZRRE-së: V_323_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në me Nenin 14.2 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.034/L-185;
- Dispozitat e Nenit 18 paragrafi 2 të Licencës për Shpërndarjes e ngrohjes qendrore të N.Q Gjakova Sh.a; dhe
- Kërkesën e Ngrohtores së Qytetit Gjakova Sh.A (N.Q Gjakova Sh.A) për emërim të ekspertit të pavarur, të datës 17 dhjetor 2010,

në seancën e mbajtur me datë 22 dhjetor 2010, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa e N.Q Gjakova Sh.a për emërimin e z. Florent Bunjaku, si ekspert i pavarur për kontrollimin teknik dhe të sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe të pajisjeve për Gjenerim të N.Q Gjakova Sh.a.

Arsyetim

- o Sipas nenit 7 të Licencës së Gjenerimit dhe Nenit 20 të Licencës së Shpërndarjes së Ngrohjes Qendrore, kërkohet nga N.Q Gjakova, që të përcaktojë një ekspert të pavarur, emërimi i të cilit do të bëhet nga ZRRE.
 - o N.Q Gjakova me datë 17 dhjetor 2010 ka dërguar në ZRRE kërkesën me propozim për emërimin e z. Florent Bunjaku si ekspert i pavarur.
 - o ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e N.Q Gjakova, dhe pas vlerësimit të biografisë së kandidatit ka aprovuar kërkesën që **z. Florent Bunjaku** inxhi. i diplomuar i makinerisë dhe mastër i shkencave teknike nga lëmi i termoenergjetikës, të jetë ekspert i pavarur i cili do të bëjë kontrollin teknik dhe të sigurisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të N.Q Gjakova dhe kontrollin teknik dhe të sigurisë në lidhje me pajisjet e Gjenerimit të N.Q Gjakova.
- II. Kërkohet nga i licencuari që më së largu deri më 31 mars 2011 të dërgoi një **raport** lidhur me kontrollin teknik dhe të sigurisë së sistemit të shpërndarjes dhe gjenerimit në përputhje me nenet e Licencave të lëshuara nga ZRRE.
- III. Kërkohet nga i licencuari, që në rast të skadimit apo anulimit të kontratës me ekspertin e aprovuar me këtë vendim, të njoftojë ZRRE-në sa më shpejtë e mundur.

IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkëngjitur: Biografia e Z. Florent Bunjaku

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar